7	Te Ardhura nga Drejtoria e Transportit dhe Licencave	105,801,650
8	Te ardhura arketim nga kopshtet e çerdhet	40,000,000
9	Te tjera(tarifa shebimi, gjoba polbashkiake e ndertimore) etj	84,966,000
10	Te ardhura nga donacione	6,451,744
	Shuma e te Ardhurave	**3,844,424,108**
	totali	**5,364,896,142**
3	3% nga lejet e ndertimit per programet e strehimit	720,000,000
	TOTA LI I BURIMEVE TE FINANCIMIT	6,084,896,142

Tabela e burimeve të financimit nga sipas viteve

Vitet	Trasfert e pakushtezuar	te ardhurat	burime	% qe ze trasferta	% qe zene te ardhurat	Transferta specifike
Viti 2019	491,970,000	619,528,127	1,111,498,127	44.26%	55.74%	168,908,898
Viti 2020	504,614,297	618,332,181	1,122,946,478	44.94%	55.06%	173,047,251
Viti 2021	527,168,496	788,075,437	1,315,243,933	40.08%	59.92%	261,200,050
Viti 2022	647,151,034	1,055,658,107	1,702,809,141	38.00%	62.00%	329,835,403
Viti 2023	665,518,632	1,808,971,806	2,474,490,438	26.90%	73.10%	365,582,918
Viti 2024	767,230,803	2,889,982,767	3,657,213,570	20.98%	79.02%	377,038,721
Viti 2025	915,129,450	3,569,180,480	4,484,309,930	20.41%	79.59%	445,858,708
Viti 2026	1,024,410,987	3,837,972,364	4,862,383,351	21.07%	78.93%	496,061,046



Të ardhurat nga burimet qendrore (transferta e pakushtëzuar) prej 1,024,410,987 lekë zënë 21.07 % të totalit të burimeve te financimit *ketu merret parasysh totali transferte e pakushtezuar e pergjithshme dhe te ardhurat e veta.*
Të ardhurat nga burimet qendrore (transferta e sektoriale) prej 496,061,046 lekë zënë 9.3 % të totalit të të ardhurave.

Të ardhurat nga burimet qendrore

Transferta e pakushtëzuar do t'i sigurojë bashkisë mbulimin e diferencës mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave te veta.
Për vitin 2026, transferta e pakushtëzuar përbëhet nga dy pjesë: a) pjesa e përgjithshme dhe b) pjesa sektoriale.
Të ardhurat nga burimet qendrore përfshijnë të ardhurat nga Transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, transferta e kushtëzuar.
Të ardhurat nga burimet qendrore janë 1,520,472,033 lekë dhe përfshijnë transfertën e pakushtëzuar 1,024,410,987 lekë dhe atë sektoriale 496,061,046 lekë si dhe transfertën e kushtëzuar që në rastin tonë eshte 0 lekë.

Të ardhurat e veta vendore

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës së kushtëzuar. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Specifika e këtyre të ardhurave, sipas nenit 40/1 të ligjit është që nëse nuk shpenzohen brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal. Pra, pjesë përbërëse e këtyre të ardhurave janë dhe ato që trashëgohen nga viti i mëparshëm.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë për vitin 2026, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kohën e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.
Gjithashtu planifikimi i të ardhurave të veta u realizua si proces në bashkëpunim me administratën e bashkisë, me Njësinë Administrative, etj. Ky proces bashkëpunues do të

mundësojë sigurimin e të ardhurave të mundshme për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë territorin e bashkisë.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore per vitin 2026

Të ardhurat nga burimet e veta vendore llogariten në 3,837, 972,364 lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burime të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga taksat *ketu merret parasysh totali transferte e pakushtezuar e pergjithshme dhe te ardhurat e veta*, (78.93 %).

Zërat e taksave dhe tarifave që ndikojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2026, janë kryesisht taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rreth 66.5 %, tarifat për pastrim, gjelberim e ndricim që zë rreth 7.82 %, taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 4.7 %, Tarifë infrastrukture arsimi e përkohshme që zë rreth 0.82 % , taksa e mjeteve të përdorura që zë rreth 1.9%.

Këto zëra kryesorë mbulojnë mbi 78 % të planit të të ardhurave të Bashkisë.
Tabela e mëposhtme pasqyron planin e të ardhurave të veta për vitin 2026, të kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik ligjor:

Tabela analitike bashkëlidhur.

Nr	EMERTIMI	PLANI Vjetor 2026	PLANI Vjetor 2027	PLANI Vjetor 2028
		0	0	0
1	Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore	664,946,067	677,145,448	697,459,812
	Taksa dhe tarifa lokale (biznes)	377,946,067	389,284,448	400,962,982
1	Takse ndertese	69,634,121	71,723,145	73,874,840
2	Tarife pastrimi te mbetjeve	109,357,273	112,637,991	116,017,131
3	Tarife gjelberim dhe ndriçim	57,734,175	59,466,200	61,250,186
4	Takse tabele	464,860	478,805	493,170
5	Taksa reklame	4,687,013	4,827,623	4,972,452
6	Taks e truallit per qellime biznesi	6,328,190	6,518,036	6,713,577
7	Tarife sherbimi	1,048,973	1,080,442	1,112,855
8	Takse hotelerise	187,460	193,084	198,876
9	Debitor viti	108,889,954	112,156,653	115,521,352
10	Takse tregjeve dhe zenie hapsirave publike	680,727	701,149	722,183
11	Takse e perkohshme e rrjetit kabllor, ajror dhe nentoksor	2,076,315	2,138,605	2,202,763
12	Taksa e kalimit te pronesise	3,477,822	3,582,156	3,689,621
13	Taksa vendore biznez i vogel (tatim fitimi)	2,060,000	2,121,800	2,185,454
14	Tarife vendore per infrastrukturen arsimore	11,319,184	11,658,759	12,008,522
15	Taksa dhe tarifa lokale (familjaret)	287,000,000	287,861,000	296,496,830

	Ndertesa	83,391,000	83,641,173	86,150,407
	Tarife pastrim,	71,087,625	71,300,888	73,439,915
	Tarife gjelberim dhe ndriçim	71,087,625	71,300,888	73,439,915
	Taksa e truallit per qellime banimi	1,003,000	1,006,009	1,036,189
	Tarife vendore per infrastrukturen arsimore (familjare)	20,310,750	20,371,682	20,982,833
	Taksa dhe tarifa lokale (familjaret) debitor	40,120,000	40,240,360	41,447,571
	Legalizimet	350,999,324	260,280,702	227,189,123
1	Taksa e ndikimlt te legalizimeve debi	321,600,584	230,000,000	196,000,000
2	Taks e ndikimit te legalizimeve v 2025	29,398,740	30,280,702	31,189,123
II	Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit te Territorit	2,552,173,244	2,570,584,419	2,580,357,952
1	Leje ndertimi,leje zhvillimi	2,491,302,284	2,491,302,284	2,491,302,284
2	Leje perdorimi	10,181,130	12,241,260	13,250,000
3	Ngritje kantjeri e muri rrethues	1,544,340	9,479,621	10,500,000
4	Piketimi I struktures	5,168,000	6,985,254	7,500,000
5	Perfundimi I themeleve	5,168,000	6,985,254	7,500,000
6	Perfundii ne fazen e karabinase	4,785,300	6,514,236	7,100,000
7	Perfundimi I fasadave dhe rifinitures	6,563,480	2,085,668	2,085,668
8	Perfundimi I sistemit te jashtem	5,369,710	7,459,842	7,600,000
9	Tarife per zhvillim	9,150,000	11,150,000	13,500,000
10	Tarife per leje	9,150,000	11,150,000	13,500,000
12	Tarife sherbimi	3,791,000	5,231,000	6,520,000
III	Drejtoria e Kadastres Pyjeve dhe Kullotave	8,129,080	8,176,100	8,246,100
1	Shitje Toke	538,480	605,900	615,200
10	Taksa mbi token	7,590,600	7,570,200	7,630,900
IV	**Drejtoria Trans liç e sherbimeve pulike**	105,801,650	109,766,500	114,839,260
1	Takse regjistrimi automjetesh	72,980,650	73,500,000	75,100,000
2	Leje transporti transporti taksi	3,940,200	4,400,000	4,900,000
3	Leje transporti transporti udhetaresh	2,870,800	3,500,000	3,990,000
4	Leje transporti transport mallrash	5,500,000	5,953,500	6,600,000
5	Leje Aktiviteti	3,510,000	4,150,000	4,800,000
6	Autorizim per tregti karburanti me pakice	9,000,000	10,000,000	11,000,000
7	Parkim I rezervuar	7,100,000	7,313,000	7,459,260
	Te tjera tarifa administrative	900,000	950,000	990,000
V	**Drejtoria Sherbimeve pulike**	30,957,000	124,402,000	124,652,000
1	Te ardhura nga parkingjet	22,500,000	115,500,000	115,500,000
2	Tarife nga MKZ	4,805,000	5,250,000	5,500,000
	Tarifa varrimi	3,652,000	3,652,000	3,652,000
VII	Te Tjera	124,966,000	123,010,290	121,087,540
1	Taks e deleguar te ardhura nga TAP	60,000,000	60,000,000	60,000,000
2	Gjoba Inspektoriati Ndertimor	9,510,000	9,510,000	9,510,000
3	Gjoba Policia Bashkiake	2,575,000	2,575,000	2,652,250
	Te ardhurat nga Qerate	2,500,000	2,575,000	2,575,000
4	Te ndryshme	10,381,000	8,350,290	6,350,290
5	Te ardhura nga kopshtet e çerdhet	40,000,000	40,000,000	40,000,000
	TOTALI	3,837,972,364	3,873,365,459	3,873,831,787
	0.1 % qe do te derdhet ne K. e Qarkut	3,837,972	3,873,365	3,873,832
	Mbeten te ardhura Bashkise	3,834,134,392	3,869,492,093	3,869,957,955
	Te ardhura nga donacione	6,451,744	**0**	**0**
		6,451,744		
VI	**te ardhura 3% strehimi**	720,000,000	500,000,000	500,000,000
3	3% strehimi	720,000,000	500,000,000	500,000,000

Të ardhurat e veta vendore

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës së kushtëzuar. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Specifika e këtyre të ardhurave, sipas nenit 40/1 të ligjit është që nëse nuk shpenzohen brenda vitit trashegohen për vitin e ardhshëm.

Kapacitetet fiskale të taksapaguesve

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat për taksapaguesit e një viti më parë, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të vitit 2026 të miratuar nga këshilli i bashkisë.
Në total numri taksapaguesve është parashikuar rreth 55,571 (familje, biznese dhe institucione).
Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e kapacitetit të taksapaguesve sipas kategorive dhe per njësine administrative.

KAPACITETI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE viti 2026
(Numri)

Nr.	Bashkia Kamëz	Familjet	Biznes i vogël	Biznes i madh
1	Kamëz	33526	2589	706
2	Paskuqan	17911	964	175
	Totali	**51,437**	**3,553**	**881**

Taksapaguesit familjarë,
Në total numri i familjeve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë është 51,437 familje. Numri i familjeve në Njësinë Administrative Kamez zë peshën kryesore me 33,526 familje ose 65.18 % të numrin të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Kamëz.
Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju përafruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e arkëtimeve në vitet e kaluara sipas zonavë me numrin e familjeve sipas gjendjes civile.
Në planin e të ardhurave janë parashikuar lehtësi fiskale për familjet me probleme sociale, si për familjet që janë invalidët, familjet vetem me pensionist dhe familjet qe preken nga projektete infrastrukturore ..etj.

Lehtësirat fiskale synojnë të mbështesin:

- Kategoritë vulnerabël (invalidë, pensionistë, të paaftë)
- Familjet me barrë të lartë sociale (nëna kryefamiljare, familje me fëmijë, jetimë)
- Familjet në gjendje të vështirë ekonomike (ndihmë ekonomike, emigracion)
- Familjet e prekura nga projekte publike
- Sipërmarrjet e kryefamiljareve gra.

1.1. Bizneset me kryefamiljare femra

Bizneset, kryefamiljaret e të cilëve janë gra, përfitojnë nga lehtësimi fiskal në formën e:

- Përjashtimit nga të gjitha tarifat vendore, me përjashtim të:
  - Taksës së ndërtesës
  - Taksës së tabelës

1.2. Bizneset e reja

- Viti i parë i hapjes së aktivitetit përjashtohet nga pagesa e të gjitha tarifave vendore.

2. Lehtësirat fiskale për familjet taksapaguese

Lehtësirat aplikohen sipas kategorive sociale, ekonomike dhe familjare.

2.1. Reduktim 30% i tarifave për familjet

Këto kategori përfitojnë 30% ulje të nivelit të tarifës familjare:

1. Invalidët e punës, të verbrit, të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë (kryefamiljarë), pa persona madhorë në ngarkim, përveç bashkëshortit/bashkëshortes.
   - Përjashtim: Mund të kenë persona madhorë vetëm nëse janë të paaftë për punë ose studentë.
2. Kryefamiljaret gra me më shumë se një fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç).
   Përfitojnë gjithashtu edhe:
   - Jetimët me status jetimi.
3. Kryefamiljarët pensionistë, pa persona madhorë në ngarkim, përveç bashkëshortit/bashkëshortes.
   - Mund të kenë persona madhorë në ngarkim vetëm nëse janë të paaftë për punë ose studentë.
4. Personat me aftësi të kufizuara (të paaftët), kryefamiljarë, pa persona madhorë në ngarkim (mbi 22 vjeç), përveç bashkëshortit/bashkëshortes.
   - Personat madhorë mund të jenë në ngarkim vetëm nëse janë të paaftë për punë ose studentë.

2.2. Përjashtim i plotë nga pagesa (0 Lekë)

Kategoritë që përjashtohen plotësisht nga pagesa e tarifave vendore:

5. Familjet që jetojnë në emigracion

- Tarifat vendore: 0 lekë.

6. Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike

- Tarifat vendore: 0 lekë.

7. Familjet që rrjedhin nga i njëjti trung familjar dhe jetojnë në të njëjtën banesë (nëse nuk kanë banesë tjetër)

- Tarifat vendore: 0 lekë.

8. Familjet e prekura nga projektet infrastrukturore

Për këto familje: 0 lekë taksa dhe tarifa vendore.

KAPACITETI I FAMILJEVE TAKSAPAGUESE

Nr.	Bashkia Kamëz	Familje me taksa e tarifa të plota	Familje me lehtësi fiskale
1	Kamez	30,053	3473
2	Paskuqan	16,032	1879
	Totali	**46,085**	**5352**

Taksapaguesit biznese dhe institucione

Bazuar në regjistrat aktual, në total, numri i bizneseve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale te bashkisë është 4.090 biznese, ku Biznesi i vogël është 3,226 biznese ose zë 78 % të numrit total të bizneseve.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për bizneset sipas xhiros, sipas institucioneve dhe Njësive Administrative:

KAPACITETI I BIZNESEVE DHE INSTITUCIONEVE TAKSAPAGUESE

Nr.	Bashkia Kamëz	Totali I bizneseve	Biznes i Vogël	Biznes i Madh
1	Kamëz	3295	2589	706
2	Paskuqan	1,139	964	175
	Totali	**4,434**	**3,553**	**881**

KAPACITETI I BIZNESEVE TË VEGJËL SIPAS NATYRËS SE TYRE

Nr.	Bashkia Kamëz	Biznesi i vogël	Njësi tregtare dhe shërbimi	Njësi prodhimi	Profesione të lira	Ambulant
1	Kamëz	2589	2,468	74	47	0
2	Paskuqan	964	918	25	20	1
	Totali	**3,553**	**3,386**	**99**	**67**	**1**

Analiza e të ardhurave të veta vendore dhe ndikimet e tyre në të ardhurat e bashkisë,

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, nga tarifat për shërbimet publike dhe të ardhurat e tjera vendore.

Sipas ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimin e tyre brenda kufijve e sipas kritereve të përcaktuara me ligj.

Llogaritja e të ardhurave të kësaj kategorie mbështetet në:

1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"

i ndryshuar;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Kamëz Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz";

Të ardhurat vendore nga taksat vendore

Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Këto të ardhura përfshijnë te ardhurat nga :
- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesat e banimit dhe mbi ndërtesat e tjera)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

a) Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat

Taksa mbi ndërtesat e banimit

Baza e taksës është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat.
Gjatë vitit parashikohet zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:
Bashkia parashikon që të gjejë mbështetje edhe tek institucionet e tjera si Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurise për saktësimin dhe përpilimin e një regjistri sa më të saktë të banesave në territorin e saj.
Planifikimi i të ardhurave per kete ze për vitin 2026 është bëre perllogaritje për çdo biznes dhe familje, tek te ardhurat e realizuara vitin e meparshen, si dhe duke iu referuar tendencës në rritje të kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite. Sipërfaqja e ndërtesave të banimit që taksohet eshte ne proces verifikimi ketu futen dhe debite e vitit te kaluar.
Persa i përket peshës së të ardhurave nga kjo taksë, nëse i referohemi kategorisë së banesave, pjesa më e madhe e të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat e banimit vjen nga banesat e ndërtuara pas vitit 1993.

Të ardhura nga taksa e ndërtesës për biznese

Kjo taksë administrohet nga Bashkia. Baza e taksës është sipas rastit sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat.
Planifikimi i të ardhurave për vitin 2026 është bërë mbi bazën e sipërfaqes aktuale të bizneseve në juridiksionin e bashkisë.
Kapaciteti totali i sipërfaqes së taksueshme për qëllime biznesi është ne proces saktesimi.
Ndërsa, nëse i referohemi kategorive të banesave, pjesa më e madhe e te ardhurave nga taksa mbi ndërtesat e tjera të biznesit vjen nga ndërtesat e biznesit për tregti e shërbime.

Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore,

Kjo taksë administrohet nga Bashkia. Baza e taksës është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose në përdorim të taksapaguesit.
Më larte paraqitet tabela e të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore, sipas kategorive të tokës dhe njësise administrative:
Gjatë vitit parashikohet saktesimi i bazës së taksapaguesve pasi pjesa me e madhe e tokes bujqesore eshte kthyer ne toke truall.

Planifikimi i të ardhurave për këtë zë për vitin 2026 është bërë duke u bazuar në kapacitetin aktual të njësive administrative dhe bazuar në parashikimin për saktesimin e bazës së taksapaguesve nga ana e grupeve te punës, nëpërmjet saktësimit të sipërfaqeve reale dhe kategorizimit të saktë dhe aktual të tokës bujqësore.
Kapaciteti total i sipërfaqes së taksueshme të tokës bujqësore është ne proces vleresimi nga grupet e punes.

Të ardhura nga taksa mbi truallin,
Taksa mbi truallin është një taksë e re që implementohet kater vitet e fundit pas ndryshimeve ligjore fiskale dhe administrohet nga bashkia. Me "Truall" kuptohet një sipërfaqe toke, jo tokë bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, të miratuar për të ndërtuar mbi të.
Baza e taksës është sipërfaqja në metër katror.
Për bizneset kjo taksë administrohet nga Bashkia.
Planifikimi prej 7,331,190 lekë është bërë duke u bazuar në sipërfaqet aktuale të banesave dhe ndërtesave të tjera.
Gjatë vitit parashikohet saktesimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet Vlerësimit të drejtë të sipërfaqeve nga grupet e punës të ngritur për këtë qëllim.

Kapaciteti total i sipërfaqes së taksueshme te truallit është ne proces vleresimi nga grupet e punes.
Ndërsa nëse i referohemi kategorive te truallit, pjesa më e madhe e te ardhurave nga kjo takse vjen nga trojet për qëllime biznesi.

Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel,

Kjo taksë administrohet nga Bashkia.
Me "*Hotel*" kuptohet çdo subjekt tregtar që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.
Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, dhe përcaktohet me ligj.
Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes, dhe mbi të vlera e taksës.
Planifikimi i të ardhurave prej 187,460 lekë për këtë zë për vitin 2026 është bërë duke parashikuar kapacitetet, numrin e njësive dhe periudhat e shfrytëzimit.

Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë,

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja administrohet nga Bashkia.
Bazuar ne nenin 39 te ligjitnr.107/2014 date 31.07.2014 "per Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit(indryshuar) , VKM nr 408 date 13.05.2015 "Per mirtatimin e rregullores se zhvillimit te teritorit", në ligjin 9632 dt 30.10.2006, etj taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja përcaktohet në kufijtë 4-8% e çmimit të shitjes për ndërtime për qëllime

banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrise apo përdorim publik.
Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve të udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.
Taksa e ndikimit në infrastructure per ndertesa shume kateshe (pallate) te ndryshme nga ato të përmendura më lart është (4+1) % të vlerës së investimit që kërkohet të kryhet.
Taksa e ndikimit në infrastrukture per ndertesa individuale (familjare) te ndryshme nga ato të përmendura më lart është (3+1) % të vlerës së investimit që kërkohet të kryhet
Planifikimi i të ardhurave per vitin 2026 per kete ze eshte 2,552,173,244 leke
Bazuar në Ligjin Nr. 9482 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", taksa për ndërtesat në proçes legalizimi llogaritet dhe tarifa e legalizimit.
Planit për vitin 2026 për këtë zë bazohet mbi parashikimin e lejeve për ndërtime të reja dhe shlyerjen e detyrimeve për objektet në proçes legalizimi.
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet në proçes legalizimi administrohet nga Bashkia është në bazë të listave përkatësë.
Vjelja e kësaj takse paraqet vështirësi për Bashkinë Kamez, pasi subjektet dhe familjarët pasi kryejnë proçedurat e legalizimit pranë ASHK, kryejnë regjistrimin e pronës pa shlyer detyrimin përkatës. Realizimi i ardhurave nga kjo taksë lidhet dhe bazohet në zbatimin e masave shtrënguese, bllokimin e shërbimit të debitorëve nga bashkia, si dhe në mbështetjen nga ASHK.

Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme,
Kjo taksë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
Taksa me nivelet sipas Ligjit Nr.9632 paguhet para kryerjes së regjistrimit nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të Bashkisë Kamëz, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.
Planifikimi i kësaj takse bëhet nga agjenti tatimor, i cili është bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara të numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga vetë ato.

Të ardhura nga taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura,
Bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare" të ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, ku pas arkëtimit nga institucione shtetërore ne rolin e agjentëve tatimorë, një pjesë e këtyre të ardhurave transferohen në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore sipas përkatësisë nga burojnë.
Referuar pikës 3, të Nenit 4 të Ligjit 9975, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara, 18% e të ardhurave nga kjo taksë kalon për llogari të Bashkisë Kamëz.
Planifikimi i kesaj takse bëhet, duke u bazuar në të dhënat e regjistruara për nivelet e taksave dhe numrin e automjeteve per vitin 2026 eshte parashikuar 72,980,650 leke.

Të ardhura nga taksa e tabelës,

Bazuar ne Ligjin Nr. 9632, dt.30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:
Tabela për qëllime identifikimi, të cilat nëse janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m² nuk taksohen.
Tabela për qëllime reklamimi, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike.
Tabela për qëllime ekspozimi, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.
E ardhura nga kjo taksë për vitin 2026, parashikohet të jetë 464,860 lekë.

Të ardhurat nga tarifat vendore,

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj;
Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.
Paketa fiskale e Bashkisë për vitin 2026 e hartuar dhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit dhe të biznesit, pasqyron disa politika të rëndësishme lehtësuese, apo ulje të niveleve nga ajo e llogaritur referuar kostos së sherbimit të ofruar.
Lehtësirat fiskale synojnë të mbështesin:
Të ardhura të tjera si nga tatimi mbi të ardhurat që do të jetë 1% e të ardhurave nga Tatimi mbi të ardhurat personale.

Për vitin 2026, tarifat janë parashikuar ne shumën 60,000,000 lekë
Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të të ardhurave nga tarifat janë të ardhurat nga tarifat Për ofrimin e shërbimeve publike, si pastrimi e largimi i mbetjeve, gjelbërimi (dhe ndriçimi publik).

Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, dhe paguhet nga familjet apo bizneset të cilët kontribuojnë dhe e përfitojnë këtë shërbim.

Ngarkesa e tarifimit është shpërndarë duke u bazuar në:
- në llojin e aktivitetit (tregti, shërbim, prodhim, profesion i lirë, fermer, aktivitet transporti, ndërtimi, karburanti, institucion, OJF, etj).
- dhe në statusin e subjektit (familjar, biznes i madh, biznes i vogël, institucion shtetëror, ambulant etj).

Parashikimi i të ardhurave nga biznesi bëhet duke u bazuar në kapacitete, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë

Të ardhura nga Tarifat e liçensimit te veprimtarive te transportit

Plani i të ardhurave prej 15,821,000 lekë të parashikuara për vitin 2026 bazohet tek tarifat e miratuara nga Ministria e Financave për subjekte që pajiset me liçensën dhe çertificatë përkatëse për transport udhëtarësh ose mallrash.

Të ardhura nga Tarifa e parkimit për mjetet e licencuara dhe për vendparkime publike
Të ardhurat prej 7,100,000 lekë të planifikuara nga tarifa e parkingut për mjetet që janë pajisur me një liçensë transporti, kur një pjesë e tyre kanë vende te caktuara me sinjalistikë. Si dhe jane planifikuar per vitin 2026 te ardhura nga parkime publike ne shumen 22,500,000 lekë.
Të ardhura nga Tarifa për dhënie liçensë për tregtimin të naftës bruto e n/produkteve
Bazuar në VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", ky zë parashikon të ardhurat vjetore prej 9,000,000 Lekë nga subjekte me aktivitet karburant, që pajisen me liçensë karburanti.
Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)
Ky zë parashikon të ardhurat vjetore prej 2,076,315 lekë.

Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri
Të ardhurat e parashikuara për vitin 2026 me vlerë 4,805,000 lekë bazohen në nivelin e tarifave të shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj, si dhe në realizimin e të ardhurave vitet e kaluara nga kjo strukturë.

Të ardhura nga Tarifa për zënien e hapësirave publike

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m2, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.
Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kapaciteteve të hapësirave publike brenda juridiksionit të Bashkisë.

Të ardhura nga burime të tjera
Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 36, te ardhura nga burime të tjera janë: të ardhurat nga dhënia me qirat e aseteve në pronësi të bashkisë; të ardhurat nga investimet mbi kapitalet; të ardhurat nga titujt dhe të drejtat e tjera të blera nga bashkia; të

ardhurat nga fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi; të ardhurat nga partneritetet privat publik.

Bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, dhuratat, interesat, gjobat, ndihmat ose donacionet. Gjithashtu Bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Të ardhurat nga kundravajtje administrative (nga Gjobat)
Gjobat bazohen në ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" te ndryshuar:"Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen me akte të këshillit bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta".

Bazuar në Nenin 10, "Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Në rastet kur kundërvajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga këshilli bashkiak, masa e dënimit përcaktohet në këto akte.
Ky zë me vlerë 19,500 mije lekë parashikon të ardhurat nga gjoba për mosshlyerje detyrimi në afate ligjore nga bizneset, gjoba nga kontrolle dhe inspektime tatimore, gjoba për kundravajtje administrative që mund të vendosen nga Policia Bashkiake, nga Inspektoriati Ndërtimit Vendor etj.

II. Transfertat nga Buxheti i Shtetit

Niveli i tranfertës së kushtezuar dhe pakushtezuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore përcaktohet çdo vit në ligjin e buxhetit të shtetit.
III.1 Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit
Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit është e ardhur për njësitë e qeverisjes vendore, e përfituar në formën e dhurimit pa kusht kthimi, pa interes, e cila përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet të njësive të qeverisjes vendore, të përcaktuara në Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
Formula e re e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë për çdo njësi (që kap diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e re e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mblidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore.
Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim fitimi i thjeshtuar i biznesit të vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridikë.

Totali i transfertës së pakushtëzuar të alokuar ne vitin 2026 për Bashkinë Kamez është 1,024,410,987 lekë. Krahasuar me vitin 2025 kjo transfertë është 109,281,537lekë më shume ose 8.93 %.

III.2 Transferta sektoriale sipas funksioneve.

Totali i transfertës së pakushtëzuar të alokuar ne vitin 2026 për Bashkinë Kamez është 496,061,046 lekë. Krahasuar me vitin 2025 kjo transfertë është 50,202,338 lekë më shumë ose 9 %.

Qendra e sherbimeve sociale

Në mbeshtetje të Ligjit Nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" në VKM nr. 510, datë 10.5.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve...", në VKM nr. 70, datë 24.10.2007 "Për transferimin në pronësi të disa bashkive të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shteteror" dhe në VKM nr. 60, datë 1.2.2006, përcaktohet se Qendra Polivalente Kamëz, institucion i përkujdesit social, kalon në administrim të pushtetit vendor, Bashkia Kamëz.

Kjo gjë është theksuar dhe në shkresën e Shërbimit Social Shtetëror nr. 2189 prot., datë 23.10.2015 " Për kalimin e Qendrës Polivalente në administrim të Bashkisë Kamëz".

Në zbatim të VKM-ve të sipërcituara, ky kalim i kësaj Qendre në administrim të Bashkisë Kamëz duhet të shoqërohet me fondet përkatëse nga Shërbimi Social Shtetëror. Por duke parë projektligjin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2026, konkretisht tabelën ku janë transfertat e pakushtëzuara dhe sektoriale për bashkitë për vitin 2026, shohim se për Bashkinë Kamëz nuk është parashikuasr asnjë fond per Qendren Polivalente ne Kamez.

Ndersa Programi "Mbrojtja sociale", sipas informacioneve ky zë do të shpërndahet në formën e transfertës së kushtëzuar si dhe në bazë të projekteve që do të paraqesin njësitë e qeverisjes vendore për investime në emergjencat civile.

IV. Shpenzimet e planifikuara për vitin 2026

Buxheti i vitit 2026 përfaqëson një angazhim të fortë të Bashkisë Kamëz për të përmirësuar jetesën e qytetarëve, për të fuqizuar shërbimet dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social të territorit. Ai është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës dhe në përputhje me nevojat reale të komunitetit.

Projekt buxheti është një proces listimi dhe analizimi të problemeve dhe sfidave emergjente, programeve dhe projekteve afatshkurtra dhe afatmesme. Gjatë gjithë periudhes komunikimi me komunitetin, takimet dhe diskutimet publike kanë ndihmuar për të përcaktuar shqetësimet dhe nevojat aq të shumta dhe me mundësi të kufizuara për tu realizuar.

Shpenzimet janë planifikuar sipas programeve funksionale:

I. Buxheti i Bashkisë për vitin 2026

Buxhetit i Bashkisë për vitin 2026 është 5,358,444,398 lekë, nga të cilat 3,844,424,108 lekë ose (71.66 %) nga të ardhurat e veta, 1,024,410,987 lekë ose (19.09 %) transfertë e pakushtëzuar, 496,061,046 lekë ose (9.25%) transfertë sektoriale, transfertë e kushtëzuar është gjendja civile, ndihmë ekonomike dhe paaftësi e kushtëzuar për të cilat çelet fondi në fillim të vitit kalenderik.

Disa tregues te rendesishem per shpenzimet viti 2026

- **Totali i shpenzimeve kapitale është 2,133,790,150 lekë dhe zë 47.06 % të totalit të shpenzimeve.**
- **Totali i shpenzimeve operative te bashkise, arsimit si dhe pastrimi (depozitim mbetjesh) është 451,342,023 lekë dhe zë 9.97 % të totalit të shpenzimeve.**
- **Totali i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqerore e shendetsore ku perfshihen dhe pagesa qe behet nga fondet e bashkise per punonjesit e kopshteve dhe cerdheve është 1,188,413,538 lekë dhe zë 26.3 % të totalit të shpenzimeve.**
- **Totali i të tjerave, emergjencat, strehimi, ndihmë ekonomike etj është 223,967,365 lekë dhe zë 5 % të totalit të shpenzimeve.**
- **Totali i të tjerave, fondi 3% i strehimit, është 720,000,00 lekë**
- **Totali i kontigj e rezerve 72,100,000 lekë dhe zë 1.7 % të totalit të shpenzimeve.**
- **Totali i shpenzimeve nga transferta specifike 496,061,046 lekë dhe ze 10.97 % te totalit te shpenzimeve.**
- **Totali i shpenzimeve per ndermarrjet e sherbimit ne varesi te Bashkise Kamez 840,959,512 lekë dhe ze 15.7 % te totalit te shpenzimeve.**

Buxheti i vitit 2026 është hartuar sipas programeve buxhetore dhe funksioneve të përcaktuara me ligj.

Buxheti është hartuar bazuar:

- Në një analizë dhe plani menaxhimi për shërbimet publike (mbledhja-grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane, ndriçimi rrugor, gjelbërim, mirëmbajtje infrastrukture rrugore, mirëmbajtje rrugë rurale, ofrimi dhe menaxhimi i shërbimit me ujë të pijshëm, mirëmbajtje objekte të arsimit parashkollor, mirëmbajtje të objekteve të arsimit, mirëmbajtje të objekteve në shërbimin shëndetësor, etj.);

Formulimi dhe prezantimi i buxhetit të vitit 2026 është bazuar në metodologjinë e hartimit, duke ndjekur me korrektësi në fakt zbatimin e detyrueshëm të Ligjit 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar i orientuar drejt produktit për shërbime dhe zhvillim për banorët e Kamzës.
Planifikimi i buxhetit është bërë mbi bazën e përcatimit të politikave programore dhe objektivave specifik të matshëm përmes treguesve sasiorë dhe cilësore, të lexueshëm dhe të monitorueshëm lehtësisht në çdo kohë, gjatë gjithë procesit të zbatimit dhe realizimit, nga çdokush: nga administrata vendore, nga këshilltarët vendore, nga organizata të shoqërisë civile, nga çdo qytetar dhe i interesuar.

P.1 Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

Politika e Programit. Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit te Bashkisë Kamez, zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese dhe në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Bashkisë.

Programi i administratës vendore përcakton menaxhimin dhe mbështetjen administrative për programet e tjera të punës, veçanërisht në vazhdimësine e zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në të gjitha nivelet e institucionit per te mundësuar përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe kuadrit ligjor në funksion.
Meqënëse qeverisja e mirë ndërlidhet me aftësinë e Bashkisë për të siguruar shërbimin më të mire për komunitetin, çdo anëtar është aktiv për të dhënë **kontributin e tij.** Prandaj, për ne ekziston një nevojë e vazhdueshme që Bashkia të veprojë si lehtësuese duke iu prirë qytetarëve:

- drejt të menduarit strategjik,
- duke i përfshirë ata në çështjet e pushtetit lokal,
- duke i bërë partnerë në zgjidhjen e problemeve.

Politikat e vazhdueshme, të cilat do të zbatohen nga administrata e bashkisë do të jenë:,

Qeverisja jonë lokale do të bazohet në parimet e sundimit te ligjit, përgjegjësisë, llogaridhënies, besimit, transparencës, efektivitetit, efikasitetit, partneritetit dhe koherencës.

I. Krijimi i një strukture menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësine dhe lehtesinë për perthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.
II. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, proçedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së qytetarëve.

Dixhitalizmi i administratës publike do të jetë një nga prioritetet tona në kuadër të programit të administratës vendore.

Ne jemi të angazhuar për të shtuar dhe promovuar shërbimet elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore, tashmë në një shtrirje të re territoriale. Qytetari do të ketë mundësi që për të gjitha shërbimet që sot ofrohen nga Bashkia, të aplikojë dhe përfitojë shërbimin në çdo Njësi Administrative.

Synimet:

- Strukturë e burimeve njerëzore funksionale që përmbush detyrimet dhe përgjegjësitë, funsioneve dhe kompetencave të reja për pushtetin vendor:
- Funksionimi normal i të gjithë administrates së Bashkisë së nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë.
- Infrastrukturë funksionale pajisjesh informatike
- Ndërtimi i një sistemi aplikativ informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.
- Bashkëpunim me antarët e këshillit vendore dhe ndërlidhësit me komunitetin për realizimin e objektivave.

Aktivitetet që synohen të realizohen

- ✓ Realizimi i pagesës së pagave dhe të sigurimeve shoqërore për nëpunësit dhe punonjësit e bashkisë.
- ✓ Plotësimi i kërkesave për kushte normale të punës në administratë.
- ✓ Sigurimi i materialeve dhe shërbimeve speciale.
- ✓ Realizimi i shërbimeve ndaj të tretëve.
- ✓ Realizimi i shpenzimeve të transportit.
- ✓ Sigurimi i levizjes së nëpunësve dhe realizimi i shpenzimeve të transportit.
- ✓ Mirëmbajtja e mjeteve të transportit, pajisjeve të zyrave dhe vet ambienteve të zyrave nëpërmjet realizimit të shpenzimeve të, mirëmbajtjes së zakonshme.
- ✓ Realizim i i shpenzimeve për pritje përcjellje.
- ✓ Realizimi i shpenzimeve të tjera operative.

Buxhetimi i Programit i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Paga Aparati	0	01110	Planifikim, Menaxhim dhe administrim	600	201,881,096	41,900,000	159,981,096	0	0
2	Sig shoq e shnd Aparati	0			601	31,255,533	15,300,000	15,955,533	0	0
3	Paga Aparati	0			606	2,060,000	0	2,060,000	0	0
4	Shpenzime operative aparati	0			602	97,129,883	39,505,914	57,623,969	0	0
1	Shpenzime operative keshilli bashkiak	0			602	1,890,500	0	1,890,500	0	0
4	Investime vazhdim	0			231	370,663,824	100,000,000	270,663,824	0	0
7	Investime 2026	0			231	51,208,229		51,208,229	0	0

10	% I ukk	0			604	14,000,000	0	14,000,000	0	0
11	1% tatimet & K garku	0			604	3,837,972	0	3,837,972	0	0
	shuma					773,927,037	196,705,914	577,221,123	0	0

Për realizimin të aktiviteteve të Programit: Planifikim, Menaxhimit dhe Administrimit vendor Prog.(01110) planifikohet buxheti me vlerë totale 773,927,037 lekë, nga të cilat kryesoret janë shpenzimet per investime si dhe shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, dhe shpenzime operative.

Shpenzimet per Investime ne kete program jane planifikuar ne vleren 370,663,824 leke, ku ketu pjesen me te madhe e ze Ndërtim i parkimit me 1 kat nëntokë, objekti 3 kat të Bashkisë Kamëz dhe rehabilitimi i sheshit si dhe shpenzime te tjera per fuksionimin e aparatit te bashkise. Shpenzimet per paga e sigurime shoqerore jane planifikuar konform legjistlacionit ne fuqi, ku jane marre parasysh te gjithe elementet e pages. Ndersa shpenzimet operative jane llogaritur ne menyre analitike per çdo lloj shpenzimi qe eshte i domosdoshem per funksionim, ketu jane parashikuar shpenzimeme si: per blerje kancelari te ndryshme, per materiale pastrimi, per blerje bojrash per printera e fotokopje, shpenzime per blerje uniforma policie e te tjera blerje materialesh te ndryshme, shpenzime per karburant qe jane llogaritur ne menyre te hollsishme per çdo lloj mjeti dhe sipas normativave te parashikuara, shpenzimet per energji elektrike, per shpenzime telefoni, interneti, posta e te tjere, shpenzime per blerje materiale te ndryshme per funksionimin e paisjve elektronike, shpenzime per mirmbajtje te ndryshme si per programet kompjuterike te tatim taksave, te kamerave te qytetit, e te tjera mirmbajtje si dhe shpenzimet per pagesat e keshilltareve dhe nderlidhesve me komunitetin, gjithashtu jane parashikuar Kuota per pjesmarje antaresie (Shoqata e Bashkive) ne vleren 600,000 leke dhe Financim I Akademise se Qeverisjes vendore ne vleren 729,509 leke.

Shpenzimet operative janë planifikuar në nivel programi.

FONDI REZERVE DHE FONDI KONTIGJENCES PER VITIN 2026

Jane planifikuar konforme legjistlacionit ne fuqi.

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Fondi kontigjences	0	,04940	Fondi kontigjences	609	51,500,000	0	51,500,000	0	0
2	Fondi rezerve	0	,04910	Fondi rezerve	609	20,600,000	0	20,600,000	0	0
	shuma					72,100,000	0	72,100,000	0	0

"Fond rezervë" është fondi, që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit, ky fond eshte parashikuar ne vleren

20,600,000 leke dhe perdoret me vendim keshilli bashkiak ne rast te situatave emergjente dhe fatkeqesive natyrore.

"Fond kontingjence" është fondi i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme, për të ardhurat dhe shpenzimet, gjatë zbatimit të buxhetit eshte parashikuar ne vleren 51,500,000 leke.

Sherbimet e Policise vendore
Programi 03140

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Paga Aparati	0	03140	Sherbimet e policise vendore	600	62,090,154	30,600,000	31,490,154	0	0
2	Sig shoq e shnd Aparati	0			601	9,875,291	5,100,000	4,775,291	0	0
	shuma					71,965,445	35,700,000	36,265,445	0	0

Administrimi i çeshtjeve dhe sherbimeve policore qe jane te nevojshme per kryerjen e funksioneve ne sherbim te rendit, qetesise dhe mbarvajtjes se puneve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda teritorit te njesise se veteqeverisjes vendore si dhe zbatimi i akteve te nxjerra nga Kryetari i Njesise si dhe vendimeve te Keshillit te Njesise Bashkiake.

Fondi i parashikuar per kete program per paga e sigurime shoqerore e shendetsore eshte sipas tabeles me siper dhe eshte llogaritur konforme legjistlacionit ne fuqi.

Fondet per shpenzime operative per kete program jane llogaritur te programi 01110.

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH)
Programi 03280

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Paga	0	03280	Sherbimi nga zjarri dhe mbrojtja civile	600	47,880,000	0		47,880,000	0
2	Sigurime shoqerore	0			601	7,756,000	0	0	7,756,000	0
3	Paga				606	1,000,000	0	1,000,000	0	0
4	Shpenzime operative	0			602	9,885,808	0	798,942	9,086,866	
5	Investime	0			231	3,140,000	0	3,140,000	0	0
	shuma					69,661,808	0	4,938,942	64,722,866	0

1	Emergjencat civile	0	03280	Sherbimi nga zjarri dhe mbrojtja civile (emergjencat civile)	602	0	0	0	0	0
2	Emergjencat civile	0			602	0	0	0	0	0
3	Emergjencat civile				606	48,484,392	0	48,484,392	0	0
4	Emergjencat civile	0			231	0	0	0	0	0
	shuma					48,484,392	0	48,484,392	0	0

Ky program i sherbimit zjarrfikes ne nivel vendor ka per qellim parandalimin, mbrojtjen nga zjarri dhe perballimi i emergjencave te tjera qe vijne nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.
Në transfertën sektoriale të vitit 2026, janë fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit. Në këto fonde bëjnë pjese fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.
Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.
Shuma e transfertes sektoriale te alokuar per kete program për vitin 2026 është 64,722,866 lekë, si dhe nga te ardhurat e bashkise jane parashikuar 4,938,942 leke.
Shpenzimet per paga e sigurime shoqerore jane parashikuar konforme legjistlacionit ne fuqi ndersa per shpenzimet operative jane planifikuar ne menyre analitike sipas kerkesave te sektorit te MZSH, ku perfshihen shpenzimet per blerje uniformash speciale per punonjesit e MZSH, shpenzime per mirembajtje dhe siguracione te mjeteve te transportit, shpenzime per sigurimin e jetes se punonjesve te MZSH, shpenzime per karburant qe jane llogaritur sipas automjeteve dhe normave te harxhimit e te tjera shpenzime operative.
Tek ky program eshte parashikuar dhe fondi i emergjencave civile ne shumen 48,484,392 leke, fond qe do te perdoret per fatkeqesi te ndryshme natyrore dhe eshte llogaritur 1.034% (3,837,972,364 leke +849,834,462 leke) x 1.034 % te totalit te buxhetit duke perjashtuar shpenzimet nga transferta sektoriale si dhe vleren e transfertes per rritjen e nivelit te pagave pasi kjo eshte ne pjesen me te madhe per rritjen e nivelit te pagave te punonjesve mbeshtetes ne kopshte dhe çerdhe.
Ndersa nga Drejtortia e Pergjithshme e Emergjencave Civile çdo vit vjen fondi per kete qellim ne formen e transfertes se kushtezuar.

Programi i Zhvillimit Ekonomik (04130) tek ky program kemi dhe programin e Rinise

Përshkrimi i programit të zhvillimit ekonomik
Bazuar në përvojat më të mira të nismave të financuara nga Bashkimi Evropian, për zbatimin e politikave zhvillimore, ndërmjet të tjerave, do të përdorim në mënyrë të kombinuar dy mjete të sprovuara për efikasitetin e tyre:
□ Zhvillimin Lokal të Udhëhequr nga Komuniteti
□ Investimet e Integruara Territoriale.
Synojmë që zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti të mobilizojë dhe të përfshijë komunitetet dhe organizatat lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke nxitur kohezionin territorial.

Programi për rininë do të ofrojë shërbimet specifike në lidhje me a) Informimin dhe këshillimin për rininë për shërbimet lokale, edukim, për formim profesional, etj., b) Vlerësimin e nevojës për mbështetje të të rinjve; c)Koordinimin e grupeve, shoqatave dhe OJF rinore; d) Bashkëfinancim të aktiviteteve rinore; e) Bashkërendim me sektorin e shërbimeve sociale, shëndetësore e të sportit për nxitjen e aktiviteteve më të rinj.

Pershkrimi i politikave te zhvillimit ekonomik

Tre janë politikat në të cilat Bashkia do të fokusojë përpjekjet e saj:
Mbështetje për përmirësimin e kushteve për fillimin dhe zhvillimin e biznesit. Synimi është që strukturat e ngritura – administrata e bashkisë, apo agjenci/qendra biznesi të mbështetura nga Bashkia – të jenë të specializuara dhe të ofrojnë shërbime të cilësisë së lartë (dhënie informacioni ligjor, fiskal, orientim bazuar në studimet zhvillimore të Bashkisë).
Në Bashkinë e Kamzes eshte vene ne zbatim programi i kompjuterizuar për regjistrimin dhe administrimin e biznesit, si dhe administrimin e taksave vendore.

Thjeshtim dhe reduktim të procedurave administrative:
□ Nëpërmjet politikave fiskale dhe shpërndarjes së drejtë të ngarkesës tatimore:
□ Përcaktimi i nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit;
Rritja e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve. Synimi është që ndërmarrjet në territorin e Bashkisë të bëhen më konkurruese në tregjet vendore dhe ndërkombëtare nëpërmjet inovacionit, zhvillimit dhe përkrahjes së markave rajonale, zhvillimit të zinxhirëve të vlerës dhe përmirësimit të sistemeve të shpërndarjes;
Zhvillimi i fuqisë punëtore të kualifikuar sipas kërkesave aktuale dhe të ardhshme të tregut përmes arsimit, trajnimit dhe ritrajnimit. Synimi është që disponueshmëria e punësimit të rritet.
Përmes përmirësimit të trajnimit të ofruar (qendrat të punësimit, programet e reja mësimore në arsimin profesional) fuqia punëtore do të jetë më konkurruese dhe e trajnuar më mirë.

Tek ky program kemi bashkar dhe shpenzimet e per sektorin e rinise si dhe mardheniet me jashte, pra drejtorine e Integrimit dhe BE-se.

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Paga Aparati	0	4130	Mbeshtetja per zhvillim ekonomik	600	30,467,178	10,200,000	20,267,178	0	
2	Sig shoq e shnd Aparati	0			601	5,062,705	1,020,000	4,042,705	0	
3	Shpenzime operative per rinine e te tjera	0			602	24,550,000	0	24,550,000	0	
	shuma					60,079,883	11,220,000	48,859,883	0	0

Fondi i paga eshte llogaritur bazuar ne strukturen e kesaj drejtorie si dhe bazuar ne legjistalcionin ne fuqi.

Shpenzime operative jane planifikuar si me poshte:

Mbeshtetje per OSHC
Parapagim per shpenzimit operacionale te Projekteve dhe Bashkefinancim Projektesh, Financuar nga BE dhe Donatore te tjere
Konsulence dhe Ekspertize e jashteme per shkrim projektesh
Organizime te Zhvillimit ekonomik(panaire, aktivitete)
Aplikim binjakezimesh dh pritje delegacionesh
Pjesmarrje ne evente nderkombetare
Buxhet per Keshillin Rinor
Aktivite per diten Nderkombetare dhe Java Evpropiane
Protokoll ceremonial
Implementimi I Planit Vendor te Rinise
Implementim I Planit Vendor te Zhvillimit Ekonomik
Aktivitet "Kinema e Hapur"
Subvencion i aboneve per studentet

Programi i Bujqesisë dhe zhvillimit rural, Ujitja dhe Kullimi, Administrimi I Pyjeve dhe Kullotave prog. (04220), (04240) & (04260)

Tek ky program në Bashkine Kamez jane perfshire Sherbimet e bujqesise, Kadastra, Mbrojta e tokes , Mbrojtja e Konsumatorit si dhe menaxhimi i Infrastruktures se Ujitjes dhe Kullimit dhe Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave.

Pershkrimi i programit

Ky program konsiston ne mbeshtetjen e zhvillimit te qendrueshem te prodhimit bujqesor. Mbrojtja e konsumatoreve dhe menaxhimi i ujitjes dhe kullimit

Përshkrimi i politikave

Ne kemi si prioritet që për këto zona të:

Ne Bashkine Kamez toka bukqesore ka ardhur drejt uljes pasi eshte kaluar ne toke truall.

Ne kemi si prioritet: mbrojtjen e tokës nga dëmtimet, erozioni, moçalizimi, Saktësimi dhe regjistrimi i të drejtave të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe kategorive të tjera në hapësirën rurale.

Bazuar ne ligjin 9902 date 17.04.2008 "Per Mbrojtjen e Konsumatoreve" ligji 139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore", ne ligjin nr 10465 date 29.09.2011 "Per Sherbimin Veterinar ne Republiken e Shqiperise neni 54, si dhe Vendimi nr 2 date 22.01.2024 "Per Rregulloren e Normimit te sjelleve dhe mbrojtjen e konsumatorit ne teritorin e Bashkise Kamez, mendohet te ndertohet nje strehez per kafshet endacak (qene).

Jane planifikuar shpenzime per investime si dhe shpenzime operative.

Shpenzimet per keto programe jane si me poshte:

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Paga	0	04220	Sherbimet e bujqesise, tokes(kadastra)	600	27,610,118	10,200,000	17,410,118		0
2	Sigurime shoqerore	0			601	4,490,964	1,020,000	3,470,964		0
3	Shpenzime operative	0			601	0	0	0	0	0
4	Investime	0			231	0	0	0	0	0
	shuma					32,101,082	11,220,000	20,881,082	0	0
1	Paga	0	04220	Sherbimet e bujqesise, tokes(mbrojtje konsumatorit)	600	23,045,400	8,000,000	15,045,400		
2	Sigurime shoqerore	0			601	3,665,316	1,000,000	2,665,316		
3	Shpenzime operative	0			602	5,000,000		5,000,000		
4	Investime	0			231	4,600,000		4,600,000		
						36,310,716	9,000,000	27,310,716	0	
1	Paga	0	04240	Menaxhimi I infrastruktures se ujitjes dhe kullimit	600	5,959,800	0	1,940,534	4,019,266	0
2	Sigurime shoqerore	0			601	947,892	0	247,892	700,000	0
3	Shpenzime operative	0			602	0	0	0	0	0
	shuma					6,907,692	0	2,188,426	4,719,266	0
1	Paga	0	04260	Menaxhimi iPyjeve dhe Kullotave	600	626,482	0	0	626,482	0
2	Sigurime shoqerore	0			601		0	0	0	0
3	Shpenzime operative	0			602		0	0	0	0
	shuma					626,482	0	0	626,482	0

Shpenzimet per paga e sigurime shoqerore jane parashikuar bazuar ne legjistlacionin ne fuqi ndersa per shpenzimet operative jane parashikuar ne menyre analitike.

Programi i Infrastrukturës rrugore (04520)

Ky program konsiston ne:

- Ndertimin dhe Mirmbajtjen e sistemeve rrugore dhe strukturave te transportit
- Sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nen administrimin dhe pergjegjesine e njesise se veteqeverisjes vendore.
- Studime per Rehabilitimin, permirsimin, nderimet e reja ne rrjetin rrugor.
- Marrja e masave per lehtesimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural te njesise vendore.

Politika e Programit. Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë territorin, me qëllim që t'iu mundësojë qytetarëve qarkullim normal në ecjen e këmbësorëve dhe qarkullimin e mjeteve, krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit te ndiçimit publik.

Pershkrimi i Programit. Programi i Mirëmbajtjes së rruge trotuareve dhe ndicimit publik ne gjithe territorin, parashikon mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, trotuareve, segmenteve rrugore, rehabilitimin e rrugeve te zhavoruara, mirembajtjen e sistemit te ndricimit të qytetit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin.

Objektivat e Programit

Bazë e të dhënave për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve;

- Rrugë urbane të mirëmbajtura
- Sheshe të mirëmbajtura
- Trotuare të mirëbajtura
- Të mirëmbahet rrjeti ekzistues i ndiçimit publik dhe të mundësohet mbulimi i zonave të reja me ndriçim.

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Investime te viteve ne vazhdim	0	04520	Rrjeti rrugor rural	231			0		0
1	Investime te viteve ne vazhdim	0			231	986,415,560	218,031,073	768,384,487		0
2	Investime te v 2026				231	412,287,420		412,287,420		0
2	Investime te v 2026				230	5,000,000		5,000,000		
	shuma					1,403,702,980	218,031,073	1,185,671,907	0	0

Tashmë rrjeti rrugor urban i qytetit lidhet me rrjetin kombëtar rrugor.
Për realizimin të aktiviteteve të Programit: Infrastruktura Rrugore vetëm për investime në ketë program janë planifikuar me vlerë totale 1,403,702,980 lekë.

Tek kjo shume perfshihen likujdimi i investimeve te infrastruktures rrugore qe jane ne vazhdim si dhe Investimet e reja ne infrastukturen rrugore qe do te realizihen sipas PBA-se 2026-2028.

2. Planifikimet për vitin 2026

Në vazhdim të punës së nisur dhe me qëllim garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të balancuar të territorit, Bashkia Kamëz ka parashikuar të vijojë investimet në infrastrukturën rrugore edhe gjatë vitit 2026.

- Për vitin 2026 është planifikuar ndërtimi dhe rehabilitimi i 80 km rrugë të tjera.
- Fokus i veçantë do t'i kushtohet:
  - Rrugëve lidhëse mes njësive administrative,
  - Aksioneve të rëndësishme ekonomike,
  - Rrugëve rurale që lehtësojnë aksesin drejt tregjeve, shkollave dhe shërbimeve bazë.

Kjo rrit ndjeshëm aksesin brenda territorit dhe përmirëson lëvizshmërinë e banorëve.

3. Përfundime Realizimi i këtyre investimeve për periudhën 2025–2026, me një total prej 160 km rrugë, përbën një hap madhor drejt modernizimit të infrastrukturës së bashkisë dhe zhvillimit të balancuar urban e rural.

Ky program do të sjellë përfitime të drejtpërdrejta për komunitetin, ekonominë vendore dhe cilësinë e përgjithshme të shërbimeve publike.

Lista e Investimeve për vitin 2026,2027,2028

Nr	EMERTIMI I OBJEKTIT	Vlera e plote	Financuar 2026	Financuar 2027	Financuar 2028
1	2	6	7	7	7
	Investime Infrastruktura Rrugore Kamez				
1	Ndertim rruget+Rikonstruksion+Ndertim trotuare Lagje Valias	206,715,517	39,275,948	108,835,720	58,603,849
2	Ndertim Rruga Nato deri tek Rruga Albanet dhe ndertim I KUZ, nga rrethi qender kamez deri tek rruga Monarkia Shqiptare.	181,722,876	34,527,346	95,677,094	51,518,435
3	Ndertim rruge Blloku 1 Fushe Kamez (nga rruga Kosova-Argjinature)	239,035,607	45,416,765	125,852,247	67,766,595
4	Ndertim rruge Blloku 2 Fushe Kamez (nga rruga Kosova-blv nene tereza))	315,826,210	60,006,980	166,282,500	89,536,731
5	Riasfaltim Bulevardi Nene Tereza dhe Rruga Teuta	72,033,000	13,686,270	37,925,375	20,421,356
6	Ndertim, Sistemim KUZ Rruga Xhorxh Ë Bush	58,598,373	11,133,691	30,852,043	16,612,639
7	Ndertim Rruget Blloku Bathore	148,758,819	28,264,176	78,321,518	42,173,125
8	Ndertim dhe Rikonstruksion Rruget Paskuqan 1, 2.	169,253,198	32,158,108	89,111,809	47,983,282
9	Rikonstruksion rruga Demokracia, ndertim trotuari rruga Azem Galica dhe Ndertim rrugica ne Paskuqan.	123,148,081	23,398,135	64,837,465	34,912,481
10	Ndertim dhe Rikonstruksion Rruget Babru ne Paskuqan	268,930,702	49,791,323	137,974,378	81,165,001
11	Sistemim Kanali nga Rruga Konferenca e Mukjes deri tek Unaza e Madhe, Paskuqan	150,701,273	28,633,242	79,344,220	42,723,811
12	Ndertim Seg.Rruga Nato-Albanet & ndertim KUZ Bulevardi Nene Terza	146,196,867	27,777,404	76,972,650	41,446,813
13	Mbikqyres Kolaudues	60,718,032	18,218,032	22,500,000	20,000,000
	Totali	**2,141,638,555**	**412,287,420**	**1,114,487,018**	**614,864,116**
	Hartim Projekt Zbatimi	**7,000,000**	**5,000,000**		**2,000,000**
14	Investime Infrastruktura rrugore te reja te periudhave ne vazhdim	2,235,236,851	986,415,560	358,690,505	890,130,786
	TOTAL KAMEZ & PASKUQAN progr 04520	**4,383,875,406**	**1,403,702,980**	**1,473,177,524**	**1,506,994,903**

Për vitin 2026 janë planifikuar investime te reja ne total shuma 2,080,920,523 lekë, nga këto do të likujdohen në vitin 2026 shuma prej 399,069,388 lekë.
Ndërsa për investimet që janë në process janë planifikuar 1,004,633,592 lekë.
Projekt - Buxheti 2026 për investime ka parasysh:

- Planin Urban **i cili është miratuar në vitin 2022 me Vendim te Keshillit Bashkiak.** Në planifikimin e shpenzimeve për investime është pasur parasysh orientimi i qeverisjes vendore që të shkohet drejt rritjes së investimeve në shërbimet publike (rrugë, ujësjellës etj).
- Qëllimet dhe objektivat e qeverisjes vendore (rritja e nivelit të investimeve, përmirësimi i raportit investime / shpenzime funksionimi.).
- Përshkrimin e programeve (planifikimi i shpenzimeve për investime me emërtimet përkatëse).
- Investimet t'i shërbejnë sa më shumë komunitetit për t'u bërë një bashki model dhe pjesë integruese e metropolit.
- Është pasur parasysh strategjia e zhvillimit të Bashkisë Kamëz, si dhe plani rregullues i tij.
- Është llogaritur kostoja e plotë për çdo projekt (edhe për financimet e pjesshme të vitit 2026 është llogaritur kostoja e plotë).
- Kerkesat e vazhdushme te qytetareve si dhe konsultimet publike.
- Buxhetin faktik të viteve paraardhëse (sidomos 3 vitet e fundit).

Në vitin 2026 parashikohet te perfundojne pjesa me e madhe e invesimeve në vazhdim nga viti 2025.

Transporti publik Programi (04570)

Ky program buxhetor synon kontraktimin e shoqerive private te transportit, rregullimin dhe mbikqyrjen e sherbimit te transportit publik vendor (miratimi i tarifave per pasagjeret dhe i orareve dhe shpeshtesise se sherbimit urban).

Përshkrimi i programit

Ndryshimet dinamike dhe llojet e kërkesave për udhëtime, ndryshimi i stilit të jetës, rritja e hapësirës territoriale dhe rritja demografike, kanë nxitur kerkesën për një infrastrukture transporti me efikase, plane të integruara për zhvillimin urban, përballimin e kërkesës për lëvizje dhe administrimin e trafikut në qytet.
Në shërbimin e transportit publik urban operohet me operator privat, me 4 shoqëri të cilat mbulojne 10 linja. Kanë në dispozicion rreth 80 autobuze urban që ofrojne transportin publik.
Meqenëse Bashkia Kamëz ndodhet jo shumë larg nga kryeqyteti (në një distancë prej 7 km), qasja e transportit dhe sidomos me transport publik urban është relativisht e lehtë.
Linja e transportit publik ndër me kryesoret dhe me të vjetrat që lidh Kamzën me Tiranën është një linjë tradicionalisht e rregullt, dhe me shumë sukses. Por njekohësisht një numër i

konsiderueshëm i shërbimeve të transportit publik urban nëpërmjet 10 linjave janë në dispozicion për qytetarët e Kamzës brenda zonës hapësinore administrative të saj.

Mobiliteti ose lëvizshmëria ka të bëjë me përdorimin më të mirë të infrastrukturës rrugore, duke i dhënë përparësi mënyrave aktive dhe të qëndrueshme të lëvizjes (ecje, pedalim, transport publik, etj.).
Me rëndësi rrënjësore është konsolidimi i linjave të transportit publik.

Për të favorizuar përdorimin e rrugës nga këmbësorët dhe biçikletat, si dhe për të promovuar një kulturë të re për përdorimin e mjeteve të transportit publik, ne do të përcaktojmë zonat me shpejtesi të limituar 30 km /orë.
Shërbimi i transportit publik do të mbulojë të gjithë zonën urbane.

Synimet:
Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sinjalistikës horizontale nëpërmjet vijëzimit si dhe përmirësimi i sinjalitikës vertikale.
Riorganizimi i linjave të transportit dhe përmirësimi i kushteve të transportit publik.
Do të zhvillohen politika të qëndrueshme dhe integruese për tranportin publik urban, transportin me mjete private, infrastrukturën kryesore dhe ndihmëse dhe përdorimin e territorit.
Vizioni i Bashkisë Kamëz për transportin publik urban synon një qasje të integruar të zhvillimit ekonomik të qytetit të përmiresimit të jetës së qytetarëve dhe të mbrojtjes së ambjentit kundrejt zhvillimit të rrjetit rrugor dhe një tranporti publik të shpeshtë, të shpejtë, të besueshem dhe komfort.
Strategjia synon aplikimin e menyrave bashkëkohore për të mundesuar një qarkullim të qëndrueshëm dhe zhvillim social ekonomik i cili do të integrojë rregullimin e të dyja formave të transportit privat dhe publik, duke përcaktuar një ekuilibër midis tyre.
Gjjithë kjo strategji për transportin publik urban do të jetë e integruar me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kamëz, ku zhvillimi i transportit publik urban synon të zgjerojë më tej rrjetin e shërbimit të ketij transporti në aspektin e zhvillimit të transportit me autobus.

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Paga Aparati	0	04570	Transporti Publik	600	19,967,094	12,240,000	7,727,094	0	0
2	Sig shoq e shnd Aparati	0			601	3,175,719	1,000,000	2,175,719	0	0
	shuma					23,142,813	13,240,000	9,902,813	0	0

Planifikimi i shpenzimeve per paga e sigurime shoqerore eshte bere bazuar ne strukteren organizative dhe konform legjistlacionit ne fuqi.

Menaxhimi i Mbetjeve Programi (05100)

Ky program buxhetor synon mbledhjen, depozitimin e mbeturinave, trajtimin, pastrimi i rrugeve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike dhe parqeve.

Veprimtarite dhe politikat per mbrojtjen mjedisore

Pershkrimi i Aktiviteteve te programit

Administrim, Mbikqyrje, Inspektim, organizim ose mbeshtetje e sistemeve te grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit te mbetjeve.

Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve te ngurta dhe shtepiake.

Masa parandaluese per uljen e ndotjes se ajrit, tokes dhe ujit .

Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese te cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Administrimi, koordinimi dhe monitorimi i politikave, planeve, programeve dhe buxheteve per promovimin e mbrojtjes mjedisore.

Identifikim, kontroll dhe menaxhim i burimeve ujore brenda teritorit te Bashkise.

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Menaxhimi I mbetjeve te integruara	0	05100	Menaxhimi i mbetjeve	602	120,000,000	0	84,300,000	35,700,000	0
	shuma					120,000,000	0	84,300,000	35,700,000	0

Shuma e mesiperme per shpenzime operative eshte per depozitimin e mbetjeve urbane. Sherbimi i Pastrimit ne Bashkine Kamez kryhet nga Ndermarja e Pastrimit Kamez.

Me poshte do te sqarojme per shpenzimet e Ndermarjes se Pastrimit.

Programi i Planifikimit urban (Urbanistikë vendore) Programi (06140)

Ky program buxhetor synon, Planifikin dhe Zhvillimin i banesave te pershtatshme ne njesine vendore, si dhe Planifikim projektim, investimeve te infrastruktures se pergjithshme.

Politika e programit. Në përmbushje të këtij vizioni, janë hartuar objektiva strategjikë , të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të Bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Është synuar që objektivat strategjike të jenë të prekshme, specifike dhe të monitorueshme, për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye, janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik, të cilët mund të detajohen dhe përmirësohen gjatë punës që Bashkia do të kryejë për zbatimin e kësaj strategjie.

Përshkrimi i programit

Territori i ri administrativ i Bashkisë, qoftë për nga morfologjia e terrenit dhe burimet natyrore, ashtu edhe nga mënyra e zhvillimit në vite, është një territor shumë i larmishëm dhe dinamik.

Ky territor përmban potenciale të shumta zhvillimore për shfrytëzimin e kësaj larmie në funksion të mirëqënies së qytetarit.

Programi i menaxhimit te territorit mbulon gjithë territorin administrativ të bashkisë me te gjitha llojet dhe karakteret e territorit si ajo urban, rural, bujqësor, natyror apo sipërfaqe ujore.

Zhvillim, perditesim, bashkerendim dhe monitorim i planeve te zhvillimit urbanistik.

Leshimi i lejeve per ndertimet e reja.

Hartimi i Planeve te zonave dhe i rregullave te ndertimit.

Përshkrimi i politikave

Një nga politikat bazë për planifikimin, administrimin dhe kontrollin e territorit të Bashkisë do të jetë zhvillimi i integruar i tij. Ne synojnë jo vetëm zhvillimin vendor të secilës pjesë përbërëse të bashkisë, por edhe integrimin e tyre me njëra-tjetrën për të siguruar mirëfunksionimin e të gjithë territorit si një organizëm i vetëm.

Zhvillimi dhe menaxhimi territorial i Bashkisë do të bazohet mbi parimet e bashkëpunimit ndërvendor dhe ndërkufitar për të siguruar rolin kyç që do të ketë bashkia në zhvillimin rajonal, si dhe në parimin e integrimit territorial të brendshëm, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë territorit të administruar nga Bashkia në konteksin e zhvillimit ekonomik, mobilitetit, burimeve natyrore, duke ju përgjigjur dinamikave zhvillimore demografike.

Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) është sfida kryesore që do ketë administrata e Bashkisë. (megjithese per Kamzen eshte hartuar PPV, duhet implementimi me njësitë administrative që janë shkrirë).

Nëpërmjet këtij dokumenti çdo njësie vendore do t'i përcaktohet një pasaportë zhvillimi. Përmes kësaj, PPV shmang zhvillimet e fragmentarizuara dhe kaotike duke nxjerrë në pah potencialet reale të çdo zone. Orienton banorët, komunitetin dhe investitorët vendas ose të huaj në investime të qëndrueshme.

Synimet:

- Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë e Kamzës në përputhje me instrumentat e planifikimit.
- Realizimi dhe azhornimi i Sistemit të Adresave në të gjithe territorin e Bashkisë.

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Paga Aparati	0	06140	Urbanistika &Planifikim Urban vendor	600	129,448,872	21,200,000	108,248,872	0	0
2	Sig shog e shnd Aparati	0			601	20,405,966	10,200,000	10,205,966	0	0
	shuma					149,854,838	31,400,000	118,454,838	0	0

Shpenzimet per paga e sigurime shoqerore e shendetsore jane parashikuar bazuar ne strukturen organizative, legjistlacionin ne fuqi dhe ne nivelin e pagave te miratuar.
Tek ky program jane pagat e Drejtorise se Palanifikimit dhe Zhvillimit te Teritorit, te Drejtorise se Projekteve & Investimeve si dhe IMT-se.

Programi i Shërbimeve Publike Vendore (06260)

Ky Program buxhetor synon, Sigurimi i Ofrimit te sherbimeve Publike Vendore.
Përshkrimi i aktiviteteve te programit

- Planifikim i permiresimit dhe zhvillimit te strukturave si: Rekreacioni, Hapsirat e perbashketa, dhe relaksuese per komunitetin;
- Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemeve dekorative te cilat permirsojne hapsiren e gjelbert te njesise se veteqeverisjes vendore.
- Ndertimi dhe zevendesimi I trotuareve,
- Ndertim. Rehabilitim dhe Mirmbajtje e Varrezave Publike,
- Mirmbajtje, permiresim i ndriçimit te rrugeve, mjediseve publike.

Programi i ofrimit të shërbimeve publike qytetarëve, bizneseve dhe të gjithë komunitetit në të gjithë territorin administrative të bashkisë përbën një nga kolonat kryesore të programit buxhetor.
Ky program përmbledh disa nga funksionet e veta të bashkise, të cilat përmbajnë sherbimet më jetike për komunitetin siç janë:, prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura, mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet në zonat e banuara, ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike.

Shërbimet publike, për nga rëndësia e tyre, ndikojnë direkt në cilesinë e jeteses së qytetarëve dhe janë një parakusht për zhvillimin social ekonomik për të gjithë territorin e Bashkisë.

Politikat e programit

Bashkia e Kamzës është e angazhuar të garantojë për të gjithë qytetarët e saj shërbime publike cilësore në të gjithë territorin e saj pamvarësisht vendodhjes së tyre.
Përmirësimi i eficences dhe efektivitetit të sherbimeve publike, modernizimi i tyre nëpërmjet përmiresimit të vazhdueshëm të teknologjisë, si dhe permirësimi i performancës së menaxhimit të shpenzimeve, duke garantuar të gjitha standartet ligjore, do të jetë një politikë kostante në ofrimin e të gjitha shërbimeve publike nga ana e saj.
Bashkia do të garantojë rritjen e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, do të siguroje pjesmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe ta orientojë atë sipas nevojave të qytetarëve.

Synimet:
Rritja e cilësisë së shërbimit të gjelberimit, ndriçimit, parqeve etj.
Shtimi dhe mirëmbajtja e siperfaqeve të gjelberta.
Përmirësimi i treguesve të monitorimit të shërbimit të furnizimit me ujë te pijshëm të qytetarëve.
Përmirësimi i funksionimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha (shiut) dhe të zeza, në qytet dhe grykëderdhjeve kryesore për të evituar problematikat e ndryshme.
Mirëmbajtje e varrezave publike.

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Inv. sherbime publike te viteve ne vazhdim	0	06260	Sherbimet publike vendore	231	5,380,000	0	5,380,000	0	0
	shuma					5,380,000	0	5,380,000	0	0

Ne kete program buxhetor per vitin 2026 jane planifikuar investime te ndryshme ne vleren 5,380,000 leke.

Tek ky program kemi dhe buxhetimin e tre ndermarjeve te varesise informacionin per ta do ta kemi me poshte, tek Buxhetimi I Ndermajeve te Varesise.

Programi i Furnizimit me Uje dhe Kanalizime (06370)

Ky Program buxhetor synon, Sigurimi i ujit te pijshem per banoret dhe bizneset brendfa teritorit te Njesise Vendore.
Funksionimi i Sistemit te Kanalizimeve dhe trajtimit te Ujrave te Zeza.
Ndertimi dhe Menaxhimi i Sistemit te Kolektoreve, Kanaleve, Tubacioneve dhe Pompave per te larguar te gjitha ujrat e zeza.

			Viti

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Investime te viteve ne vazhdim	0	06370	KUZ	231	56,838,692		56,838,692	0	0
	shuma					56,838,692	0	56,838,692	0	0

Fondi i Planifikuar per kete program buxhetor nga bashkia eshte 56,838,692 leke qe jane Investime te perudhave ne vazhdim (te meparshme)

Funksioni i Furnizimit me Uje dhe Kanalizime Realizohet nga Ujesjelles Kanalizme Kamez sha, e cila e parashikon vete buxhetin per kete fuksion.
Bashkia Kamez eshte 100% aksionere per U.K.K sha.

Programi i Sport dhe argetim (08130)

Përshkrimi i programit

Ky program buxhetor konsiston ne:

- Organizimi i aktiviteteve sportive, çlodhese e argetuese, zhvillim dhe administrimin e institucioneve e te objekteve qe lidhen me ushtrimin e funksioneve.
- Venie ne funksionim ose mbeshtetje e strukturave per veprimtari ose ngjarje sportive.
- Mbeshtetje per ekipet perfaqesuese vendore ne veprimtarite sportive.
- Mbeshtetje e strukturave per veprimtari ose ngjarje sportive.
- Venie ne funksion ose mbeshtetje per ambjente qe perdoren per veprimtari çlodhese.

Tabela e shpenzimeve për sportin

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Paga sporti dhe administrata e arsimit	0	08130	Sport dhe argëtim	600	14,571,270	6,120,000	8,451,270	0	0
2	Sigurime shoqerore	0			601	2,317,526	1,224,000	1,093,526	0	0
3	Shpenzime operative	0			602	7,300,000	0	7,300,000	0	0
4	Sporti Transferta te Basketbolli	0			604	5,000,000	0	5,000,000	0	0
5	Sporti Investime vazhdim	0			231	94,866,228		94,866,228	0	0
	Shuma Sporti					124,055,024	7,344,000	116,711,024	0	0

INFORMACION MBI AKTIVITETET QË ZHVILLON SEKTORI I SPORTIT PRANË DREJTORISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

1. **KUPA RINORE "SFIDA"**
   Ky aktivitet i përvitshëm zhvillohet në kategorinë U16 dhe U18 meshkuj dhe femra me nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të Bashkisë Kamëz nga viti 2022 e në vazhdim. Në këtë garë përfshihen disiplinat sportive si më poshtë:
   Volejboll, Basketboll, Futboll, Shah dhe Ping-pong. Marrin pjesë ekipet e 18 shkollave 9-vjeçare dhe 6 shkollave të mesme të Bashkisë Kamëz me përfshirjen e rreth 300 nxënësve/sportistë.

2. **EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA**

   Ky aktivitet sportive zhvillohet nga Komiteti Olimpik Shqiptar në bashkëpunim me sektorin e Spotit të Bashkisë Kamëz që nga sezoni i pare 2022-2023. Mamentalisht jemi në sezonin e katërt 2025-2026. Në këtë garë përfshihen ekipet sportive të shkollave në shkallë vendi në disiplinat:
   - Volejboll
   - Basketboll

3. **KAMZA MARATHON**
   Ky aktivitet zhvillohet me pjesëmarrjen e sportistëve profesionistë dhe amatorë nga vendi dhe diaspora.

4. **KAMZA OPEN**
   Ky aktivitet zhvillohet në artet marciale ku marrin pjesë sportistë nga e gjithë Shqipëria dhe Rajoni i Ballkanit.

5. **JAVA EVROPIANE E SPORTIT**
   Zhvillohet në disiplina të ndryshme si:
   - atletikë
   - gjimnastikë
   - ushtrime të lira
   - kros

6. **DITA OLIMPIKE E SPORTIT**
   Zhvillohet në disiplina të ndryshme si:
   - atletikë
   - gjimnastikë
   - ushtrime të lira
   - kros

7 - Ekipi i basketbolli **"KAMZA BASKET"** përfaqëson Bashkinë Kamëz në SUPERLIGËN KOMBËTARE TË BASKETBOLLIT që nga viti 2009 e në vazhdim. Është shpallur disa here fitues i kampionatit kombëtar të basketbollit, Kupës së Shqipërisë dhe Superkupës së Shqipërisë.

8 - Ekipi i futbollit **"Triumf Kamza"** është regjistruar pranë FSHF për here të pare në sezonin futbollistik 2025-2026, në kategorinë e tretë.

Programi i Kultures, eventet artistike dhe kulturore (08220)

Përshkrimi i programit

Ky program buxhetor konsiston ne:
Organizim, mbeshtetje e ngjarjeve kulturore ne bashki, mbrojtje dhe promovim i vlerave te trashegimise kulturore.
Bashkia Kamëz ka në administrim Pallatin e Kulturës, me salla dhe ambjente, një ndër pallatet më të mëdha në vend.
Programi ynë synon fuqizimin e strukturës administrative dhe mirëorganizimin e institucioneve aktuale të kulturës së Bashkisë.
Pjesë e programit do të jetë mbështetësja dhe nxitësja e zhvillimit të jetës kulturore dhe artistike, nëpërmjet institucioneve dhe enteve lokale.
Do të realizohen veprimtari të ndryshme artistike si, takimi i rapsodeve, festivali multikulturor, takimi i Ansambleve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, koncerte të ndryshme si për festat e nëntorit dhe festat e fundvitit.
Do të organizohen veprimtari të tjera si promovime librash, organizime për të rinjtë, veprimtari përkujtimore për data dhe ngjarje historike,

Përshkrimi i politikave

Zbulimin dhe zhvillimin e talenteve në fushën e artit, sportit, si dhe edukimi dhe përçimi i vlerave kulturore dhe sportive do te jete nje nga politikat e programit.
Bashkia do të mbështesë dhe kontribuojë në fuqizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve mbeshtetese dhe promovuese për librin dhe lexuesit e tij me synimin e ndërthurjes së politikave vendore dhe strategjive ndërkombëtare për bibliotekat publike.
Organizim ose mbeshtetje per ngjarjet kulturore (koncerte, shfaqe artistike etj,)

Synimet:

Garantimi i shërbimeve mbështetëse për mirëfunksionimin e institucioneve kulturore dhe artistike.
Investime në tërheqjen e artisteve si valltare, soliste, instrumentiste, aktore, të cilët të jenë pjesë organike e pallatit të kultures ku të funksionojnë si gjysëm profesioniste.
Vënja në funksion e sallës së kinemasë.

Fondi i planifikuar ne programin e Q.Kulturore është 175,623,639 lekë

Nr						Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6

	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Paga	0	08220	Trashegimia kulturoeë, eventete artistike dhe kulturore	600	87,315,984	41,000,000	46,315,984	0	0
2	Sigurime shoqerore	0			601	13,887,399	7,140,000	6,747,399	0	0
3	Paga	0			606			0		0
4	Shpenzime operative	0			602	17,167,000	0	17,167,000	0	0
5	Sporti Investime	0			231	57,253,256		57,253,256		0
	Shuma kultura					175,623,639	48,140,000	127,483,639	0	0

Fondi i planifikuar për këtë program për shpenzime operative.është 17,167,000 lekë. Ndërsa struktura e organike e personelit të pallatit të kultures është pjesë përbërëse e strukturës së bashkisë.

Disa nga aktivitete social kulturore qe do te realizohen gjate vitit 2026 jane:

Projekt. 1 Maj-Pikturojme ne Natyre,2026
Projekt. 1 Maj-Pikturojme ne Natyre,honorare 2026
Projekt.2 "1 Qershori-koncert per femije"2026
Projekt.2 "1 Qershori-koncert per femije"honorare 2026
Projekt.5 "Festivali FolkYouth"-Kamez, 2026
Projekt.5 "Festivali FolkYouth"-Kamez, honorare 2026
Projekt.6 Panairi I Librit "Kamza Lexon" 2026
Projekt.6 Panairi I Librit "Kamza Lexon" honorare 2026
Projekt.7 Promovime Libri(shtator qershor) 2026
Projekt.7 Promovime Libri(Prill/Tetor) honorare 2026
Projekt.8 "Ekspozite Pikture" Kamez 2026
Projekt.8 "Ekspozite Pikture" Kamez honorare 2026
Projekt.9 "Koncerti dhe Panairi I Dites se Veres" Kamez 2026
Projekt.9 "Koncerti dhe Panairi I Dites se Veres" Kamez honorare 2026
Projekt.12 Festivali Teatrot "RinArt" - Kamez ,honorare 2026
Projekt.13 "Tingujt e liqenit" Kamez, honorare 2026
Projekt.14 Panairi Artizanal " Trashegimia Kulturore dhe Identiteti Kombetar" Kamez, 2026
Projekt.14 Panairi Artizanal " Trashegimia Kulturore dhe Identiteti Kombetar" Kamez, honorare 2026
Projekt.16 Shfaqje artistike (Janar Dhjetor) 2026 honorare

Programi i Arsimit baze (parashkollore) (09120)
Programi i Arsimit mesem te pergjithshem (09230)

Përshkrimi i programit 09120
Ky program konsiston në, mbeshtetjen e arsimit parashkollore dhe arsimit bazë, administrim dhe rregullim i sistemit arsimor, parashkollor në kopshte.

Programi i arsimit bazë parashikon veprimtarinë ekonomike, financiare dhe atë të shërbimit në mirëmbajtjen e kopshteve, cerdheve dhe shkollave 9-të vjecare, të mesme të përgjithshme dhe profesionale që janë brenda territorrit dhe juridiksionit të Bashkisë.
Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë.
Shkolla duhet t'i mundësojë çdo fëmije që të ketë rezultate të kënaqshme në mësime, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare.
Me ndarjen e re territoriale, Bashkia duhet të sigurojë mirëmbajtjen e një numri të madh institucionesh arsimore. (shkolla, kopshte, ...etj), që kërkojnë një vëmendje të veçantë. Synimi ynë është menaxhimi me efikasitet i fondeve për arsimin dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë.

Ne administrim te Bashkise Kamez kemi 52 objekte arsimore nga keto: 7 Çerdhe, 21 Kopshte, 24 shkolla.
Numeri i femijeve ne kopshte dhe çerdhe jane rreth 6,000 femije dhe shkolla rreth 20,000 nxenes ne arsimin 9 vjeçar dhe te mesem.
I gjithe teritori i Bashkise Kamez eshte i mbuluar me kopshte dhe çerdhe me te gjitha standartet bashkekohore

Përshkrimi i politikave

Krijimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në sektorin e arsimit parauniversitar dhe mbulimi i plotë i territorit me institucione të arsimit parauniversitar.
Sigurimi i shërbimeve mbështetëse, cilësore në të gjithë territorin, për institucionet e edukimit parauniversitar dhe atij parashkollor gjatë procesit të realizimit të programit mësimor vjetor.
Përmirësimi i sistemeve të edukimit dhe trajnimit profesional dhe ndërlidhja e politikës arsimore me politikën social-ekonomike.
Mbështetja dhe promovimi i cilësisë së mësimdhënies dhe i rezultateve të larta në shkollë.
Promovimi dhe nxitja e hapjes së strukturave të edukimit jashtë orarit mësimor, për të plotësuar një nga të drejtat bazë të fëmijëve, siç është argëtimi, loja, sporti etj.

Synimet:

Synimi ynë është menaxhimi me efikasitet i fondeve për arsimin dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë.

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Paga	0	09120 adm	Arsimi bazë dhe parashkollor	600	50,534,946	24,720,000	25,814,946		0
2	Sigurime shoqerore	0			601	8,037,463	3,000,000	5,037,463	0	0
4	Shpenz operative Arsimi	0			606	0	0	0	0	0
6	Investime te reja Arsimi 9-vjeçar te viteve te kaluara	0			231	74,882,116		74,882,116		0
8	Ndihme per nx.te dalluar, bursa etj	0			606	8,000,000	0	8,000,000	0	0
9	Ndihme per nx.jetim , e probleme sociale rimbursim ushqimi kopshte	0			606	3,500,000	0	3,500,000	0	0
2	Shuma arsimi administrata					144,954,525	27,720,000	117,234,525	0	0
1	Paga	0	09120	Arsimi bazë dhe parashkollor	600	472,223,780	90,000,000	117,859,684	264,364,096	0
1	Sigurime shoqerore	0			601	78,861,371	10,000,000	23,861,371	45,000,000	0
2	Shpenzime operative	0			602	113,742,832	42,030,000	71,712,832	0	
4	Shpenz operative Arsimi	0			606	3,090,000	0	3,090,000	0	0
	shuma					667,917,984	142,030,000	216,523,888	309,364,096	0
1	Paga	0	09230	Arsimi i mesem I pergjithshem	600	16,875,007	0	3,764,797	13,110,210	0
2	Sigurime shoqerore	0			601	2,818,126	0		2,818,126	0
3	Shpenzime operative	0			602	7,400,000	4,000,000	3,400,000	0	0
4	Ndihme per nx.te dalluar, bursa etj	0			606	6,975,000	0	6,975,000	0	0
5	Ndihme per nx.jetim, e probleme sociale	0			606	600,000	0	600,000	0	0
	shuma					34,668,133	4,000,000	14,739,797	15,928,336	0

Perveç Transfertës Specifike kemi planifikuar dhe shpenzime nga të ardhurat e veta.

(Arsimi)

Në këtë zë shpenzimesh përfshihen shpenzimet për funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të arsimit parauniversitar.

Bashkitë kanë kompetencë të plotë për të siguruar mirëmbajtjen dhe funksionimin e të gjitha ambienteve të arsimit parauniversitar. Fondet për funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve parauniversitare janë përfshirë në buxhetin e bashkisë me konkretisht shpenzimet për arsimin parauniversitar për Bashkinë Kamëz janë si më poshtë:

Në total shpenzimet operative të arsimit 9-vjeçar janë planifikuar **113,742,832 lekë,** ndërsa për arsimin e mesëm janë planifikuar **6,975,000 lekë.**

Gjithashtu kemi planifikuar dhe shpenzimet në llog.606 për arsimin 9-vjeç **11,500,000** lekë dhe për arsimin e mesëm **7,575,000** lekë që do të përdoren për mbeshtetje financiare për nxënësit ekselent, si dhe për te tjera bursa e shpenzime.

Një pjesë të mirë të shpenzimeve operative në arsim zënë :shpenzimet për energji elektrike, për të planifikuar këtë zë shpenzimesh është pasur parasysh numri i shkollave dhe i kopshteve si dhe harxhimi mesatar mujor për çdo shkollë.
Tek Shpenzimet operative tek arsimi jane dhe shpenzimet per blerje ushqimesh, uji, gazi per kopshte dhe çerdhe , ku vlen te theksojme se ka mbeshtetje per femijet familjet e te cileve trajtohen me ndihme ekonomike dhe PAK.

Shpenzimet operative janë planifikuar në nivel programi.
Kemi parashikuar dhe investime qe do te kryhen ne arsim si nderimi i kopshit Qender Kamez.
Gjithashtu janë parashikuar dhe shpenzime për mobilje e paisje te ndryshme ne kopshte e nga të ardhurat e bashkisë.
Prioritet për vitin 2026 siç ka qene dhe viti 2025, do të jetë mirfunksionimi i kopshteve dhe i çerdheve, si dhe ndertimi i kopshtit qender Kamez.
Tarifa për kopshtet me drekë do të jetë sipas legjislacionit në fuqi, ndërsa për shtresat në nevoje do të jetë falas.

Mbrojtja Sociale

Programi (10430)
Ky program konsiston
Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale në nivel vendor për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, fëmijët, gratë kryefamiljare, grate e dhunuara, viktima te trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmije, të moshuarit..... sipas mënyrës të përcaktuar me ligj. Dhenia e ndihmes ne para dhe natyre per personat e moshuar, per te lehtesuar jeten e tyre te perditshme, integrimin ne jeten shoqerore. Ofrimi i asistences në para dhe në natyre për të dhene mbrojtje shoqerore per familjet, femijet.
Ndërtim dhe administrim i qendrave per ofrimin e shërbimeve sociale, vendore.

Pershkrimi i Programit

Tek ky program jane perfshire, punonjesit e ndihmes ekonomike, te PAK-ut, barazise gjinore, kujdesi i femijeve si dhe menaxhimi i Çerdheve.
Në mbështetje të analizës së situatës social–ekonomike në territorin e Bashkisë Kamëz dhe në vijim të politikave sociale të miratuara për vitin 2025, paraqitet kërkesa për buxhetin e vitit 2026 për trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve në nevojë nga të ardhurat e bashkisë.

Kërkesa buxhetore bazohet në kategoritë përfituese të përcaktuara, të cilat përfshijnë:

1. Fëmijë me status jetimi në vështirësi ekonomike
2. Fëmijë me kujdestari ligjore në vështirësi ekonomike
3. Fëmijë me një prind në vështirësi ekonomike
4. Familje që jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme
5. Të moshuar të vetmuar pa të ardhura të mjaftueshme
6. Familje me persona invalidë në kushte shumë të vështira ekonomike
7. Familje me kryefamiljar në burg dhe fëmijë të mitur

8. Familje me probleme të rënda shëndetësore që kërkojnë ndërhyrje të kushtueshme
9. Familje të prekura nga fatkeqësi natyrore.

Zë i ri specifik – Shtesë buxhetore për grate dhe vajzat e dhunuara.

Në përputhje me Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore si dhe me kërkesën e paraqitur nga Aleanca e Këshilltareve Bashkiake Kamëz, propozohet krijimi i një zëri specifik buxhetor brenda fondit të ndihmës ekonomike, i dedikuar për gratë e dhunuara dhe viktimat e dhunës në familje, të cilat kanë nevojë për mbështetje emergjente dhe të përkohshme për të siguruar strehim, ushqim, shërbime bazë dhe integrim social.

Fondet e kërkuara synojnë të sigurojnë mbështetje të qëndrueshme për familjet në nevojë, të rrisin efikasitetin e skemës së ndihmës ekonomike dhe të zgjerojnë ndikimin social në grupet më vulnerabël, duke reflektuar prioritetet e politikave sociale dhe zhvillimore të Bashkisë Kamëz për vitin 2026.

Fondi i planifikuar per ndihme ekonomike per familjet ne nevoje sipas kategorive te sipercituara eshte ne shumen 25,000,000 leke qe do te perdoret gjate vitit 2026, konforme legjistlacionit ne fuqi dhe bazuar ne Vendimet e mara ne Keshillin Bashkiak.

Ne Bashkine Kamez funksionon Qendra Multi Funksionale e cila eshte ne sherbim te personave me nevoja te veçanta, gjate vitit 2025 ka vazhduar dhe sherbimi levizes ne familje per disa kategori te personave me PAK.

Fondi i planifikuar per Qendren Multifuknsionale per vitin 2026 do te jete 20,657,799 leke, nje pjese e fondeve do te perballohet nga donatoret.

Shpenzimet operative jane planifikuar ne nivel programi dhe jane per mirfunksionimin e kesaj qendre.

Nr	Emertimi	Gr	Prog.	Emertimi I Programit	Art	Viti 2026				
						2,026	Kap 1	Kap 5	Kap 1	Kap 6
						Totali Vjetor	trasferta Kamez	te ardhura Kamez	trasferta sektoriale	te ardhura Kamez
1	Paga Aparati	0	10430	Perkujdesi social (ndihma ekonomike& pak)	600	52,418,394	25,500,000	26,918,394		0
2	Sig shoq e shnd Aparati	0			601	8,337,021	4,080,000	4,257,021		0
3	Ndihme ek emergjente	0			606	22,000,000	0	22,000,000		0
4	te tjera ndihma				606	3,000,000	0	3,000,000		0
	Shuma					85,755,415	29,580,000	56,175,415	0	0
1	Paga Aparati	0	10430	Perkujdesi social (qendra multifunksionale)	600	16,145,136	0	13,498,761		2,646,375
2	Sig shoq e shnd Aparati	0			601	2,536,663	0	2,133,663		403,000
3	Shpenzime operative	0			602	1,976,000	0	1,326,000		650,000
4	te tjera ndihma				606	0	0	0		0
	Shuma					20,657,799	0	16,958,424	0	3,699,375
1	Paga Aparati	0	10430	Perkujdesi social (çerdhet)	600	131,268,983		76,268,983	55,000,000	0
2	Sig shoq e shnd				601	21,921,920		11,921,920	10,000,000	0
3	Ndihme ek				606	600,000	0	600,000		0

	emergjente									
4	Shpenzime operative		çerdhet		602	45,300,000	11,400,000	33,900,000		0
	Shuma					199,090,903	11,400,000	122,690,903	65,000,000	0

Shpenzimet per Çerdhet jane ne shumen 199,090,903 leke.
Shpenzimet per paga e sigurime shoqerore jane parashikuar bazuar ne strukturen organizative dhe sipas nivelit te pagave te miratuar.
Shpenzimet Operative jane ne shumen 45,300,000 leke, ku perfshihen shpenzimet per energji elektrike, ushqime, gaz, uje, materiale fjeteje e te tjera shpenzime.
Shpenzimet Operative jane paraqitur ne nivel Programi.
